

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik me kohë të plotë në kategorinë “Lektor” dhe kategorinë “Asistent-lektor” pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë:**

**A. Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Lektor” pranë Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të kenë përfunduar studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Energjistikë ose studimet e ciklit 5 vjeçar në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Energjistikë;
2. Të zotërojnë minimumi gradën shkencore “Doktor”;
3. Të kenë notë mesatare (ose të ponderuar) të diplomave të studimit mbi 8.0;
4. Të zotërojnë një gjuhë të huaj me dëshmi (preferohet anglisht);

**Kritere të tjera që duhet të plotësojnë kandidatët:**

- Nota mesatare në lëndët matematikë, fizikë dhe elektroteknikë të jetë mbi 8.0;
- Preferohet të kenë eksperiencë pune në sektorin elektroenergjitikë;
- Preferohet të kenë eksperiencë në mësimdhënie dhe aktivitete kërkimore-shkencore në fushën përkatëse;
- Preferohet të kenë qenë drejtues dhe pjesëmarrës në Projekte të ndryshme;
- Të kenë aftësi komunikuese për transferimin e njohurive tek studentët.

**B. Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Asistent-lektor” pranë Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të kenë përfunduar studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Energjistikë ose studimet e ciklit 5 vjeçar në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Energjistikë;
2. Të kenë notë mesatare (ose të ponderuar) të diplomave të studimit mbi 8.0;
3. Të zotërojnë një gjuhë të huaj me dëshmi (preferohet anglisht);

**Kritere të tjera që duhet të plotësojnë kandidatët:**

- Nota mesatare në lëndët matematikë, fizikë dhe elektroteknikë të jetë mbi 8.0;
- Preferohet të kenë eksperiencë pune në sektorin elektroenergjitikë;
- Preferohet të kenë eksperiencë në mësimdhënie dhe aktivitete kërkimore-shkencore në fushën përkatëse;
- Preferohet të kenë qenë drejtues dhe pjesëmarrës në Projekte të ndryshme;
- Të kenë aftësi komunikuese për transferimin e njohurive tek studentët.
- Grada/titulli përbën avantazh.

**II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje e dokumentit të gradës së fituar “Doktor” të noterizuar;
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **15.04.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.